Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-27
Datë 25.05.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2018 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), në Vushtrri me adresë Rruga Gjergj Kastrioti Skenderbeu p.n, për periudhën 25.04.2018 deri 25.04.2021 me kualifikimet:

   1.1. Polic i ri, Niveli V sipas KKK me 362 kredi të AAP.

   1.2. Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës, Niveli V sipas KKK me 160 kredi të AAP.

   1.3. Zyrtar doganor, Niveli IV sipas KKK me 131 kredi të AAP.

   1.4. Zyrtar korrektues, Niveli IV sipas KKK me 90 kredi të AAP.

   1.5. Zyrtar Sprovues, Niveli V sipas KKK me 58 kredi të AAP.

   Validimi i kualifikimeve dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet sipas raporteve vlerësuese të validimit dhe raporteve vlerësuese të akreditimit për:

   - Polic i ri, kushtet nga pika 1 deri në pikën 6, sipas raportit vlerësues të validimit dhe raportit vlerësues të akreditimit;
   - Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës, kushtet nga pika 1 deri në pikën 5, sipas raportit vlerësues të validimit dhe raportit vlerësues të akreditimit;

- Zyrtar doganor, kushtet nga pika 1 deri në pikën 4, sipas raportit vlerësues të validimit dhe raportit vlerësues të akreditimit;
- Zyrtar korrektues, kushtet nga pika 1 deri në pikën 4, sipas raportit vlerësues të validimit dhe raportit vlerësues të akreditimit;
- Zyrtar Sprovues, kushtet nga pika 1 deri në pikën 4, sipas raportit vlerësues të validimit dhe raportit vlerësues të akreditimit.

(Afati kohor: 30. 08. 2018)

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.
Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

3. Vendimi i dërgohet:

- Akademisë së Kosovës për Siguri Publike; dhe
- AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa